

MENDIME MBI PROJEKTLIGJIN "PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Pas shqyrtimit të kujdesshëm të këtij projektligji u theksua nevoja që adreson ky projekt ligj për organizimin dhe rregullimin e mënyrës së funksionimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë në kushtet e problematikave në rritje, pasojë e masivizimit të këtij arsimit në vitet e fundit si dhe të zvogëlimit të financimeve nga buxheti i shtetit. Projekt ligji me të drejtë trajton së bashku elementët e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, porë jo vetëm në ofrimin si shërbim publik, por edhe të matjes së cilësisë së ofruar. (Biologjia)

Ligji duhej të sqarojë më saktë dhe më qartësisht kuptimin e Institucioneve Publike Autonome dhe të Pavarura. Nuk vërehet një balancë e drejtë ndërmjet neneve të institucioneve publike të varura dhe të pavarura. Në ligj propozohen shumë Qendra shërbimi dhe Agjenci që e bën zbatimin kompleks dhe burokratik. Për regjistrim në studimet e arsimit të lartë të ndiqet aplikimi direkt në shkollat e larta dhe jo përmes agjencive. (Biologjia)

Numri i VKM të domosdoshme për vënien në funksionim të këtij ligji, të pritshme për tu përgatitur dhe miratuar nga Qeveria, është shumë i madh. Kjo do të kërkojë një kohë të gjatë deri në fillimin e zbatimit të plotë ligjit në diskutim. Ligji përmban kontradiktën e autonomisë së institucioneve kundrejt numrit të madh të agjencive. Standartizimi dhe unifikimi është më i drejtuar në ligj nga IAL publik dhe pak ose aspak tek ato private. Të theksohet funksioni dhe rëndësia e njësisë bazë për menaxhim dhe administrimin e burimeve dhe financës. Të vendoset stafi ndihmës si pjesë e departamentit, meqë ai është pjesë e rëndësishme ndihmëse e procesit mësimor dhe kërkimit shkencor në departament. Shtesa e personelit me administratorë për departamente vlerësohet peshë administrative shtesë. Të shtohet një nen specifik që të dy agjencitë të shpallin rankimin e punës shkencore dhe mësimore dhe më pas të merret vendimi për transformimin potencial. (Biologjia)

Projektligji të shprehe në mënyrë me eksplicite përberësit e punës shkencore dhe matshmerine e tyre. Projektligji ka gabime drejtshkrimi. Mjafton të shohesh neni 1 pika b. (Informatika) Në tërësinë e tij Projektligji për Arsimin të Lartë dhe Kërkimin Shkencor (ALKSH), i hartuar mbi bazën e një analize të plotë dhe realiste të gjendjes, është në përputhje me kërkesat aktuale dhe perspektive të shoqërisë sonë për ALKSH si dhe me objektivat e përfshirjes në Hapësirën Evropiane të Arsimit dhe Kërkimit Shkencor. (Fizika)

Vlerësohet përmbajtjen e projektligjit dhe reflektimin në të të mjaft prej propozimeve të dhëna në fazën e parë të diskutimit të tij. (Bioteknologjia)

Fakulteti te disponoje nje Keshilli Fakulteti ku studentet te kene perfaqesine e tyre me nje numer anetaresh te percaktuar e cila te parashikohet dhe percaktohet ne Projekt Ligjin per Arsimin e Larte. Ndryshe si mund te merren vendime mbi te ardhmen tone neqoftese ne nuk japim apo shprehim mendimet tona ne lidhje me ne. (Këshilli Studentor)

Ka paqartësi në mareveshjet që duhet të lidhen për departamente që kanë lëndë që administrohen nga departamente të tjera. Tek ne të gjitha departamentet kanë raste të tilla edhe brenda fakultetit. Të gjitha këto departamente duhet të nëshkruajnë marrëveshje?(Matematika e Aplikuar)

Detyrat dhe të drejtat e Rektorit, Dekanit, Përgjegjësit të Departamentit duhet të jenë të përcaktuara në ligj. Eshtë mirë që Rektori të mos drejtojë Senatin dhe as Dekani Asamblenë e njësisë kryesore. Statuti i Universitetit duhet të aprovohet nga i gjithë stafi i Universitetit; po kështu dhe cdo ndryshim në të. Duhet të shtohet patjetër e drejta e zgjedhësve për të shkarkuar të zgjedhurin e tyre në rast mos performance apo dhe për çdo arsye tjetër. Konsiderohet mangësi që nuk ka krijuar pozicionin e Profesorit dhe Profesorit të Asociuar, do ishte mirë të mos jenë tituj, por pozicion pune. Mungon hierarkia e organizimit të Njesisë Bazë si dhe të Grupeve mësimore-kërkimore bazuar në pozicionet e mësipërme. Të përcaktohen qartë pozicionet shtetërore që duhet të zërë një profesor, për t'u rikthyer në Universitet pas mbarimit të mandatit (kryesisht deputet, ministër, kryetar gjykate, etj), pra termi: poste të larta shtetërore të specifikohet. E pa qartë ndarja punonjës mësimor dhe shkencor. Personeli mësimor dhe shkencor duhet të specifikohen. Ka tepër agjensi, kështu për shembull agjensia e cilësisë dhe akreditimit të jenë një e vetme. Të lejohen pedagogët të punojnë me kohë të pjesshme (part time) në të paktën dy institucione të tjera të arsimit të lartë. Nuk duhet kufizuar numri i universiteteve ose të përcaktohet me orë javore. (Kimia)

Asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore, si organ drejtues, është vështirë të administrohet për shkak të numrit të madh të anëtarëve. Të sqarohen/përkufizohen disa terma të rëndësishëm që përdoren si "...arsimi i lartë është *shërbim publik*", etj. Nga fondet publike të përfitojnë më shumë ose vetëm IAL publike. Departamenti të organizohet në katedra shkencore dhe grupe mësimore-kërkimore-shkencore. Të ndryshojë legjislacioni në fuqi për të ardhurat nga puna për të tretët, etj.; përfitues të jetë departamenti dhe stafi i departamentit.(Fizika)

Neni 2. **“Misioni i arsimit të lartë”, pika 1.b** të hiqet shprehja "...duke i shërbyer rritjes së standardeve demokratike". (Fizika)

Neni 4 “Autonomia e institucioneve të arsimit të lartë”

- a) për të përfituar fonde nga shteti dhe organizma të tjerë;
shto: b/1) për të percaktuar pagën baze mujore dhe shpërblimet për personelin akademik dhe ndihmës-akademik.
- b) për të caktuar rregullat e brendshme të financimit dhe shpërndarjes së të ardhurave sipas veprimtarisë dhe nevojave të institucionit; **shto:** “si dhe të shpërblimeve për personelin akademik dhe ndihmës-akademik.” (Kimia Industriale)

Neni 6 ‘Përkufizime’: Te percaktohet kuptimi i disa termave “Tarife regjistrimi mos është tarife aplikimi? (Informatika) Mungon përkufizimi i institucionit publik dhe jo publik (Kimia) Duhet të plotësohet me përkufizime të tjera, psh. Pas pikës n) “Diplomë e përbashkët” duhet të shtohet “Diplomë e dyfishtë ose e shumëfishtë” (Double degree, multiple Degree), sepse këto të fundit tashmë jo vetëm nxiten EU por edhe zënë një vend shumë më të rëndësishëm Arsimit të Lartë Evropian dhe në botë. (Fizika)

Neni 7 “Ministria përgjegjëse për arsimin” : pika 2f, **“Ministria shqyrton dhe vendos mbi hapjen e programeve të reja të studimit, pezullimin dhe mbylljen e tyre** “çdo institucion duhet të jetë i lirë të hapë programet e studimit që do. Ministria i kontrollon, pezullon dhe mbyll (Kimia); pika 2m. bie ndesh me autonominë financiare të IAL, në lidhje me **“sigurimin e infrastrukturës së nevojshme për veprimtaritë kërkimore-shkencore në institucionet publike të arsimit të lartë”.** (Kimia Industriale); pika 3b nuk duhet të lihen kompetencë e ministrit shpallja e datës së zgjedhjeve në IAL. Këto zgjedhje janë periodike me afat të percaktuar dhe është përgjegjësi e institucionit të respektojë afatin. Ministri thjesht kontrollon ligjshmërinë. (Kimia); pika 3ç të zhvendoset në vend tjetër se nuk është detyrë e Ministrit, por e Rektorit (Kimia)

Neni 8 “Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor” të kalojë nën varësinë e Kuvendit dhe të jetë me mandat 6 vjeçar. Kjo do ta bënte atë të pavarur nga qeveria dhe do të eliminonte rrezikun e ndryshimeve në sistemin arsimor çdo herë që do të ndërrohen qeveritë. (Kimia)

Neni 9, 10, 11: Adresojnë krijimin, funksionimin dhe drejtimin e QShA, ndër të cilat edhe rregullimin e shërbimeve për qytetarët dhe institucionet dhe ofrimin e shërbimeve ndaj të tretëve. Në nenin 11 sugjerojmë të përshkruhet në detaje mënyra e organizimit prej QShA e rregullimit të shërbimeve ndaj të tretëve prej IAL. (Bioteknologjia) Për nenin 11, pika a sugjerojmë: QShA organizon aplikimin për praninë të studentëve në programet e studimit të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë si edhe ato profesionale,

me përjashtim të studimeve të doktoratës dhe studimeve specializuese afatgjata, në të gjitha institucionet e arsimit të lartë. (Informatika)

Neni 14. **Aplikime dhe Rregjistrimi pranë IAL**, gjykojmë se është i rëndësishëm pasi lehtëson administratën e IAL gjatë procesit të verifikimit të të dhënave të aplikantëve, por hyrja në fuqi e këtij funksioni të QSHA mendojmë se kërkon egzistencën pranë saj të një database me gjithë të dhënat e nevojshme. (Bioteknologjia) Nuk del e qartë roli i QSHA-së në procedurën e përzgjedhjes së studenteve e në programet e studimit të ciklit të dytë pasi shprehet : " QSHA u komunikon aplikantëve programe studimit të institucionit të lartë ku ata janë pranuar". dhe nenin 28, pika c, thuhet : Departamenti përcakton kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi dhe përzgjedh studentët fitues. (Matematika)

Neni 20 **"Organizimi i institucioneve të arsimit të lartë"**Mendim: Institucionet e arsimit të lartë të jenë të organizuara në institucione publike, dhe jopublike. (Kimia Industriale) Të hiqet nga pika 1) e nenit 20, shprehja *"institucione të pavarura publike"*.Të hiqet nga ky nen pika 3. (Kimia Industriale; Fizika); Të hiqet pika 3 "Institucionet e pavarura publike të arsimit të lartë janë persona juridikë publik që krijohen nga Këshilli i Ministrave me kërkesën e personave juridik shtetëror, publik dhe privat, që organizohen dhe funksionojnë sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi për fondacionet. (Fizika)

Neni 27, **"Instituti kërkimor-shkencor"**, Pika 1. "... Ai ofron programet e studimeve master i shkencave dhe doktoratë dhe/ose mbështet realizimin e tyre në rastet kur programet ofrohen nga njësi të tjera kryesore të institucionit" të hiqet shprehja "programet e studimeve master i shkencave" dhe të lihet vetëm doktoratura. (Fizika)

Neni 28 **"Departamenti"** Pas pikës 10 të shtohen pikat:

1. Departamenti ka të drejtë të vendos për rekrutimin e personelit akademik dhe ndihmës akademik.
2. Departamenti ka të drejtë të jap vlerësimin për përfitimin e gradave shkencore dhe titujve akademik.
3. Departamenti ka të drejtë të propozoj për dhënien e shpërblimeve dhe vlerësime materiale për personelin e tij akademik dhe ndihmës akademik.
4. Departamenti ka të drejtë të propozoj për hapjen e vëndve të reja të punës në përputje me ngarkesën e personelit akademik dhe personelit ndihmës-akademik. (Kimia Industriale)

Neni 29, **“Qendra kërkimore-shkencore”**: Të përcaktohet që vec stafik akademik ka edhe staf ndihmës-akademik sic është e përcaktuar tek Departamenti. U kërkua që edhe në të ardhmen, Muzeu dhe Kopshti të jenë pjesë e FSHN. (QKFF)

Neni 33 **“Hapja, mbyllja, ndryshimi i një institucioni të arsimit të lartë”**, pika 4 nuk është e qartë se ç’ndodh në rast se senati e kundërshton vendimin e ministrit për hapjen , mbylljen apo riorganizimin e IAL. (Kimia)

Neni 36” **Statuti dhe rregullorja e institucioneve të arsimit të lartë”** pika 2 **“Statuti hartohet nga senati dhe administratori i institucionit dhe miratohet nga Bordi i Administrimit me të paktën dy të tretat e votave të anëtarëve të tij”** – Propozojmë të shkruhet: Statuti hartohet nga senati dhe administratori i institucionit dhe miratohet *me të paktën dy të tretat e votave të asambleve të personelit akademik të njësisë kryesore të tij.* (Kimia)

Neni 38 **“Hapja dhe mbyllja e programeve të studimit në institucionet e arsimit të lartë”**, pika 7 të shtohet Zvicra e cila njehsohet kudo me shtetet e BE. (Kimia)

Neni 39 **“Autoritetet drejtuese dhe organet në institucionet e arsimit të lartë”** pika 8, të shtohet mënyra e shkarkimit të një autoriteti drejtues që duhet të jetë nga zgjedhësit me 50+1 të votave, me propozim të 20% të zgjedhësve. (Kimia) Të shtohet një nen ku të përcaktohet si organ kolegial edhe *asambleja e personelit akademik të njësisë bazë*. Ky organ të ketë kompetencën e hartimit dhe miratimit paraprak të buxhetit të njësisë bazë, miratimin e listës së studentëve të përzgjedhur në të gjitha programet e studimit që ofron Departamenti. Të përcaktojë strukturën e personelit të Departamentit, të zgjedhë përgjegjës të Departamentit, të propozojë hapjen / mbylljen e programeve të veta të studimit, etj. (Kimia)

Neni 40, **“Senati akademik ”** pika 4 **“Në senatin akademik përfaqësohen edhe studentët, sipas përcaktimeve në statutin e institucionit të arsimit të lartë”**: Duhet menduar më shumë mbi skemat alternative të përfshirjes së studentëve. Ligji duhet të përcaktojë një përqindje përfaqësimi të dhënë. (Biologjia) Senati nuk duhet të drejtohet nga Rektori, por nga një drejtues i zgjedhur nga vetë senati, i cili mund të shkarkohet në rast mosperformances apo për arsye të tjera nga 50% + 1 të anëtarëve të Senatit. Senati është kontrollues dhe garant i veprimtarisë së Rektorit. Të përcaktohet me ligj se si kontrollon punën e Rektorit dhe Rektoratit. Ka një centralizim të tepruar të pushtetit të senati i cili përcakton të gjitha detyrat dhe të drejtat e gjithë organeve drejtuese. (Kimia)

Neni 42 **“Rektori”, pika 2**, Në institucionet e arsimit të lartë, ai zgjidhet nga asambletë e personelit akademik **shto: dhe personelit ndihmës-akademik** të njësisë kryesore. (Kimia Industriale) Në zgjedhjen e Rektorit të Universitetit të Tiranës të behen zgjedhje të hapura me votim të fshehtë sic janë bërë dhe me përparësi dhe domosdoshmerisht Studentet duhet të kenë të drejtë e Votes në masën 20% (Këshilli Studentor); pika 4 :Kontradiktë: Rektori nuk mundet të drejtojë dhe të raportojë para senatit; pika 6 –

Kontradiktë me detyrën e senatit të neni 41 pika 1b, dhe me nenin 52 pika 1. (Kimia) Të mos lejohet kandidimi për Rektor i personave jashtë personelit akademik. (Kimia; Matematika); Rektori nuk duhet të jetë “Kryetar i Senatit” (Fizika)

Neni 44 “Asambleja e Personalit Akademik” pika 2 “Asambleja e Personelit Akademik zgjedh : Rektorin, Zgjedh Anetaret e Senatit Akademik, Zgjedh drejtuesin e njësise kryesore”: Pse gjith kjo fuqi zgjedhore ne duart e tyre dhe jo cdo gje te behet si me perpara me Kandidatura te hapura dhe votime te fshehta. Ku eshte fuqia studentore ketu. Ku do ndihet zeri jone dhe nga kush do perfaqesohemi ne në keto organe vendim-marrese. (Këshilli Studentor) Të shtohet një pikë ku të shkruhet se asambleja e personelit akademik e shkarkon një autoritet drejtues me 50% + 1 të votave, me propozim të 20% të zgjedhësve. Në nenin 44 duhet shkruar qartë për asamblenë e personelit akademik të njësisë kryesore se si mblidhet, si funksionon, si merr vendimet, kush e drejton, kompetencat e saj. (Kimia)

Neni 45. “Drejtuesi i njësisë kryesore”. Sugjerojmë që për zgjedhjen e drejtuesit në nivel departamenti të zëvendësohet e drejta e zgjedhjes me dy mandate në të gjithë karrierën me jo më shumë se dy mandate rradhazi. (Bioteknologjia) Te kene te drejten e kandidimit per Drejtues Departamenti personeli me grade Doktor.(QKFF) **Për pikë 2:** Në institucionet e arsimit të lartë ai zgjidhet nga asambleja e personelit akademik **shto: dhe personeli ndihmës-akademik** të njësisë kryesore... (Kimia Industriale) Ne zgjedhjen e Dekanit te Fakultetit ne Universitetit te Tiranës te behen zgjedhje te hapura me votim te fshehte sic jane bere me perpara dhe domosdoshmerisht Studentet duhet te kene te drejten e Votes 20% (Këshilli Studentor) Duhet ta përcaktojë rolin e Dekanit si rol vetëm akademik, ashtu siç e përcakton për Rektorin. Të mos lejohet kandidimi për Dekan i personave jashtë personelit akademik. (Kimia, Matematika).

Neni 48 “Drejtuesi i njësisë bazë” Ai zgjidhet nga asambleja e personelit akademik **shto: dhe personelit ndihmës-akademik** të njësisë dhe mbi bazën e rezultateve zgjedhore, emërohet nga Drejtuesi i njësisë kryesore..... (Kimia Industriale)

Neni 51 “Përbërja dhe krijimi i bordit të administrimit”: Shprehet mendimin se rektori dhe dekani duhet të jenë anëtarë të Bordit të Administrimit. Shprehet mendimin se raportet e propozuara mbi përfaqësimin e IAL dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë si dhe numrin total i tyre në bordin e administrimit të IAL të paraqitura në nenin 51 pika 2 nuk favorizojnë misionin e tij të shprehur në nenin 52 pika 1 nënpika b: “garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe është përgjegjës për përmbushjen e misionit të IAL-së”.(Matematika)

Neni 52 “Funksionet e bordit të administrimit” pika 1c - buxheti nuk duhet të hartohet nga administratori, por nga njësitë bazë (departamentet), senati nuk jep mendim, por duhet ta

aprovoje paraprakisht. Pas miratimit paraprak në Departament, vetëm atëherë Administratori mund ta paraqesë për aprovim në bordin e administrimit. (Kimia)

Neni 53 “Mbarimi i parakohshëm i mandatit të autoriteteve dhe anëtarëve të zgjedhur të organeve të institucionit të arsimit të lartë” pika 4 duhet të shtojë shkarkimin nga zgjedhësit me 50% + 1 te votave dhe jo ta lerë këtë në dorë të Statutit. (Kimia)

Neni 55 “Funksionet e administratorit”: Duhet të qartësohet mënyra dhe pjesëmarrja e stafit akademik dhe studentëve në hartimin e buxhetit. Të caktohet qartë në ligj se ky proces duhet të kryhet nga njësi bazë. (Biologjia); Pika 1. a (Administratori) “përcakton kriteret...” fjala “përcakton” të zëvendësohet me “propozon”. (Fizika)

Neni 56 “Administratori i njësisë kryesore”: Administratorët e departamenteve nuk duhet të jenë të detyruar me ligj, por të caktohen në varësi të detyrave dhe sasisë së parave që do ketë në administrim departamenti. Pagesa e këtyre duhet të bëhet nga buxheti i Ministrisë dhe jo nga fondet e Departamentit. (Matematika e Aplikuar)

Neni 60 “Personeli i institucioneve të arsimit të lartë”Personeli i institucioneve të arsimit të lartë përbëhet nga personeli akademik **shto: personeli ndihmës-akademik** dhe personeli administrativ. (Kimia Industriale; Fizika)

Neni 61 “Statusi i personelit akademik” Statusi i personelit akademik duhet të vendoset me ligj. Të shtohet një pikë ku të shkruhet: *Statusi i personelit akademik përcaktohet me ligj të veçantë.* (Kimia)

Neni 62 “Kategoritë e personelit akademik”, pika 3,4: Të shikohet ndarja e propozuar, dhe grada Dr të jetë lektor, aq më shumë për të fituar titullin Prof.Ass duhen 5 vite lektor. (QKFF)

Neni 63 “Titujt akademikë”, pika 1c “Titujt akademikë jepen nga institucionet e arsimit të lartë, të cilët kanë të punësuar si personel akademik jo më pak se tetëmbëdhjetë profesorë, të angazhuar me kohë të plotë me kontratë me kohëzgjatje të papërcaktuar”: Numri i profesorëve duhet precizuar sipas fakulteteve. Dhënia e titujve nuk duhet mbyllur brenda institucionit (Biologjia)

Neni 66 “Personeli akademik i ftuar”, pika 4 “Shpenzimet për personelin akademik të ftuar përballohen nga të ardhurat e institucionit” të ndryshohet si vijon: “Shpenzimet për personelin akademik të ftuar përballohen nga të ardhurat nga Buxheti i Shtetit”. (Kimia Industriale)

Neni 67, “**Viti akademik sabatik**”, të shtohet “ gjatë këtij viti lektori paguhet me pagë të plotë”. (Fizika)

Neni 68 “**Punësimi i personelit akademik**” pika 3 – si ngarkesë e punësimit me kohë të pjesshme e stafit akademik në IAL të tjera, të vendoset në ligj një ngarkesë maksimale javore e lejuar dhe të mos merret leje nga drejtuesi i njësisë kryesore, por të informohet drejtuesi i njësisë bazë (pasi drejtuesi i njësisë kryesore mbi cilën bazë do aprovojë ose refuzojë punësimin?) (Kimia)

Neni 69 “Kohëzgjatja e punësimit të personelit akademik”

Pika 2., të ndryshohet si vijon: Personeli akademik që mban titullin “Profesor i asociuar”, Doktor dhe Master, shërben në detyrë deri në moshën sipas Ligjit të pensionimit në Republikën e Shqipërisë. Personeli akademik që mban titullin “Profesor i asociuar”, mbështetur mbi nevojat e institucionit të arsimit të lartë dhe me pëlqimin e tij ai mund të shërbejë në detyrë edhe pas moshës së pensionimit përmes kontratave me kohëzgjatje deri në një vit, të përsëritshme. (Kimia Industriale)

Pika 3., të ndryshohet si vijon: Personeli akademik, që mban titullin “Profesor” shtohet dhe “Profesor i asociuar”, mund të shkëputet përkohësisht nga institucioni i arsimit të lartë, për një periudhë maksimale prej pesë vjetësh, e rinovueshme, për t’u angazhuar në detyra të rëndësishme shtetërore dhe politike. Të shtohet edhe pozicionimi me ligji i stafit me titullin Akademik ose Akademik i Asociuar, për moshë pensionimi deri në 75 vjeç. (Kimia Industriale)

Të përcaktohet që dalja në pension të bëhet në fund të vitit akademik. (Biologjia) Sugjerohet që të kenë mundësi për shkëputje nga puna jo vetëm profesorët por dhe anëtarët e tjerë të Departamentit. (Matematika) Kohëzgjatja e punësimit të personelit akademik, të shtohet një pikë e veçantë, 4. Personeli akademik, pas moshës 68 vjeç për profesorët dhe 65 vjeç për profesorët e asociuar, me pëlqimin e tij ai shërben në detyrë deri në mbylljen e vitit akademik. (Fizika)

Neni 72 “**Forma e studimeve dhe pranimit në institucionet e arsimit të lartë**”, pika 5 përmend Inspektoratin e Arsimit të Lartë, pa pasur mbështetje në ligj në nene të tjerë të tij. (Biologjia) Cili është Inspektoriati Shtetëror i Arsimit të Lartë ? Të vendoset te përkufizimet. (Kimia)

Neni 82 “**Studimet e doktorates**”, pika 2 – Të shkruhet në mënyrë eksplicite se marrëveshja duhet të jetë e vlefshme vetëm me institucione kërkimore-shkencor jo për institucione të tjera. (Kimia); **pika 5:** Sugjerohet se për drejtimet shkencore teorike numri i udhëheqjeve të doktoratave nga profesorët të jetë më i vogël se 5. (Matematika)

Neni 83 **“Programet e përbashkëta të studimit”** të bëhet “Programet e përbashkëta të studimit dhe diploma të shumëfishta” dhe të shtohen nenet përkatës. (Fizika)

Neni 85 **“Programet e studimit në fushën e arsimit të mesëm”** Nuk saktësohet se si ndahet niveli i studimeve për arsimin e meëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë. Në pika 3 shprehet : Programet e studimit në fushën e arsimit të mesëm organizohen në dy cikle të njëpasnjëshme, respektivisht programi i ciklit të parë Bachelor dhe programi i ciklit të dytë Master i Shkencave në dipsiplina përkatëse në përfundim të të cilave përgatiten mësues të arsimit të mesëm të ulët e të lartë. Sugjerohet që këto dy nivele të ndahen duke futu dhe një program studimi Master profesional. (Matematika); Pika 4, *“Organizimi i programeve të ciklit të dytë të studimeve për përgatitjen e mësuesve duhet të jetë i ngjashëm së paku në masën 80% në nivel kombëtar”*. Duhet të hiqet sepse programi i studimit është kompetencë vetëm e departamentit. Edhe praktika e deritanishme është e gabuar. (Fizika)

Nenin 91 **“Kohezgjatja e Studimeve”** nuk jemi dakord që : Kohezgjatja maksimale e studimeve nuk mund te jete me e madhe se dyfishi i kohezgjatjes normale te percaktuar dhe mendojme se ky Nen duhet rishqyrtuar. (Këshilli Studentor)

Neni 96 **“Struktura e kërkimit-shkencor”**: Instituti merr të drejtën e studimeve të ciklit të tretë, për rrjedhojë kuptimi është se Instituti merr të drejtën për të dhënë mësim (cikli i tretë). Kjo bie ndesh me nenin 110.2. (Biologjia)

Neni 97 **“Kërkimi Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë”**, pika 4” **Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë, nëpërmjet veprimtarisë kërkimore-shkencore, të zhvillimit dhe krijuese, shërbime për të tretë**”: Te përcaktohet me “sipas nivelit ku krijohet”. (Biologjia)

Neni 100 **“Vlerësimi i cilësisë së kërkimit shkencor”**, pika 2: Agjencia dhe institucioni duhet të jenë përgjegjës për publikimin e cilësisë së vlerësimit. (Biologjia) Si bëhet vlerësimi i kërkimit shkencor në AKKSH dhe nga cili?(Kimia)

Neni 103 **“Të drejtat dhe detyrimet e studentëve”**, pika 3 **“Studentët kanë të drejtë të organizohen në këshilla studentore në nivel njësie bazë, njësie kryesore, institucioni të arsimit të lartë si edhe në nivel kombëtar ose organizime të pavarura, të cilat nuk zhvillojnë veprimtari politike dhe ekonomike”**: Studentëve iu jepet mundësia të organizohen në këshilla studentore por thjesht si organ informativ për studentet asgjë më tepër. Sipas Projekt Ligjit, Këshilli studentor nuk ka asnjë përfaqësues në Këshillin e Fakultetit. Për rrjedhojë nuk ka të drejtën e votës në favor të të drejtave tona si studentë. Cdo gjë propozohet dhe miratohet pa asnjë përfaqësues të studentëve që të miratojë

nëse ajo cka propozohet është në favorin tonë. Studentët duhet të kenë te drejtë të vlerësojnë me votë cilësinë e mësimdhënies dhe punës së personelit. Në rast se vlerësimi i studenteve për personelin e caktuar nuk arrin nivelin e mjaftueshem atëherë të cilësohet si i pa kualifikuar sipas vendit të punës, në përputhje me Nenin 141 dhe të merren masat e përcaktuara nga ky nen i këtij ligji. (Këshilli Studentor) Gjykohet se neni 103 të hiqet se ngjason me një akt nënligjor. Pika 3 e këtij neni t'i bashkangjitet nenin 102.(Matematika)

Neni 113 “Akreditimi”: Kush paguan kostot në rast se nuk akreditohet dhe nuk lëshon diploma? Duhet të detyrohet institucioni të dëmshpërblejë studentët dhe të paguajë një gjobë për dëmin e shkaktuar, humbjen e 3 viteve shkolle. Akreditimi institucional duhet të bëhet para se të fillojë funksionimin një Universitet.(Kimia)

Neni 114 “ Parime bazë të financimit të institucioneve të arsimit të lartë nga Buxheti i Shtetit” pika b “Parimet bazë të financimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë nga Buxheti i Shtetit janë mundësitë e barabarta për institucionet e arsimit të lartë, në varësi të statusit që ato kanë”: Kuptimi i kësaj pike është shumë evaziv. Të qartësohet “statusi sipas renditjes”. (Biologjia)

Neni 115 “Autonomia financiare e institucioneve të arsimit të lartë”: Të hiqet fjalia e fundit e pikës 4 “ Përdorimi i të ardhurave të akorduara nga Buxheti i Shtetit për institucionet jopublike bëhet në përputhje me përcaktimet e Bordit të Administrimit”.(Kimia Industriale)

Neni 116 “Burimet e financimit të institucioneve të arsimit të lartë”: përcakton që dhe institucionet jopublike marrin financime të paspecifikuara nga buxheti i shtetit. Kjo duhet të cilësohet që për IAL jopublike nga buxheti financohet vetëm kërkimi shkencor. (Kimia)

Neni 118 “Granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë” pika 2 “Fondi për mbështetjen e infrastrukturës akademike shpërndahet mbi bazën e renditjes së institucioneve publike të arsimit të lartë të kryer nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor”: Si bëhet renditja, kriteret e vlerësimit? (Kimia)

Neni 120 “Granti i punës kërkimore-shkencore”: Duhet shtuar elementi i transparencës. (Biologjia)

Neni 126 “Krijimi dhe transformimi në institucion të pavarur publik të arsimit të lartë”: duhet të japë në mënyrë më të qartë procedurën e krijimit (Biologjia)

Neni 127 **“Përbërja dhe krijimi i bordit të administrimit”**: vlerësohet i paqartë funksionimi i bordit. Ndaj duhet të qartësohet anëtarësia dhe përbërja e Bordit. (Biologjia)

Nenet 126-130 Me propozimin e heqjes të formës së organizimit të IAL me statusin e *“institucione të pavarura publike”*, automatikisht bien. (Kimia Industriale)

Neni 133 **“Institucionet publike ekzistuese mund të transformohen në institucione pavarura publike, me kërkesë të institucionit për riorganizim të tij dhe miratim me vendim të Këshillit të Ministrave duke nisur nga viti akademik 2015-2016”**: Duhet saktësuar cili është forumi si për shembull **“duhet të jetë Asambleja forumi që merr vendimin për transformimin e institucionit”**. (Biologjia)